



Prishtinë, 13.05.2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2016\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2503\_03\_24** i datës 05.03.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 29.03.2024.

### në seancën e mbajtur më datë 13.05.2024 nxori këtë:

#### V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N.H nga Komuna e Gjakovës ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2503\_03\_24 i datës 05.03.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

#### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 05.03.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2503\_03\_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës ishte kontestuar korigjimi i dt. 28.08.2023 në vlerë prej -224.88 €, ashtu që, DMK kishte vendosur ta anulojë këtë korigjim dhe e ka obliguar KESCO-n, që t'i korigjojë faturat e konsumatorit për periudhën 03/2028 – 07/2023 në vlerë prej -308.41 €.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori N.H brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative;
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
- 

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 13.05.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 29.03.2024; Vendimin e DMK të datës 05.03.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 26.07.2023; Përgjigjen e KESCO-s të datës 05.09.2023, Ankesën e konsumatorit në DMK ZRrE-së të datës 22.11.2023; Korrigjimin me nr. 28390GJ – 5502 e dt. 28.08.2023; Rrjedhën e energjisë elektrike dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 26.07.2023 i ka dërguar konsumatorit faturën per periudhën korrik 2023 me **12,999 kWh** apo e shprehur ne vlerë financiare **1,310.66€**. Me datë 26.07.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturën e muajit korrik 2023 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsori elektrik nr. 64681099. Me datë 05.09.2023 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar ne rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit dhe transaksionet ka bere korrigjimin ne vlerë **-224.88€** duke bere shpërndarjen e kWh te faturuar per periudhën 05/2022 deri ne periudhën 07/2023.

Bordi ka analizuar me kujdes rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime te rregullta mujore dhe se në periudha te ndryshme ka evidentuar se nuk ka qasje ne leximin e shpenzimeve, konsumatori është faturuar ne mënyrë te vlerësuar dhe se ne shumicën e rasteve ka evidentuar se leximi behet ne mënyrë manuale kurse ne periudhën 07/2023 ka evidentuar se leximi behet me sond. Po ashtu, është shqyrtuar edhe periudha korrik 2023 dhe konstatohet se kjo nuk mund te paraqet shpenzim real te konsumatorit por qe paraqet kWh te grumbulluar per shkak te leximit jo te saktë. Bordi po ashtu vëren se konsumatori nga periudha 02/2016 kur edhe i është vendosur per matje njehsori nr. 64681099 deri ne periudhën 02/2018 përveç periudhës 01/2018 kur lexuesi ka evidentuar se nuk ka qasje ne lexim te shpenzimeve ka pasur lexime dhe faturime te rregullta mujore kurse nga periudha 03/2018 deri ne periudhën 07/2023 konsumatori ne periudha te ndryshme nuk ka lexime dhe faturime te sakta te shpenzimeve mujore e qe është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1.Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2.Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Pas ankesës se konsumatorit, me datë 28.08.2023 Departamenti i faturimit ne KESCO përmes korrigjimit nr. 28390DGJ-5502 ka bere korrigjimin në vlerë **-224.88€** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën 05/2022 deri ne periudhën 07/2023 per shkak te faturimit pa matje dhe bazuar ne leximet softuerike. Bordi ka shqyrtuar korrigjimin e bere nga Departamenti i faturimit ne KESCO dhe vëren se ne faturën e periudhës 05/2022 si vlerë reale te shpenzimit ka marr TL= 1663 kWh



dhe TU=9675 kWh apo 11,338 kWh dhe se kjo ne asnjë rast nuk mund te paraqet shpenzim real mujor te konsumatorit. DMK ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese, pasi që konsumatorit bazuar ne listat e leximit është dashur që ti behet shpërndarja e kWh te faturuar nga periudha 03/2018 deri ne periudhën 07/2023 në vlerë -308.41€. Po ashtu kWh e shpërndarë (1,189 kWh/muaj) per këtë periudhe përputhën plotësisht me shpenzimin mesatar te konsumatorit per periudhën 08/2023 deri ne periudhën 02/2024 (1169.85 kWh/muaj) e per te cilën ka pasur lexime dhe faturime te rregullta mujore.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, Anëtar

\_\_\_\_\_  
Arta Isufi, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit N.H dhe
- Arkivit të ZRRE-së.